

Nr.	Data e Regjistrimit të kërkesës	Data e Kthimit të Përgjigjes	Kërkesa	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës
1	03.01.2024	03.01.2024	Informacion për mbetjet farmaceutike në Shqipëri.	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	E deleguar
2	03.01.2024	29.01.2024	Informacion për pacientët e shëndetit mendor që trajtohen në spitalet psikiatrike në Shqipëri, numrin e pacientëve me probleme të shëndetit mendor, "Plani i Veprimit të Shëndetit Mendor 2023-2026", numrin e spitaleve dhe investimet në to.	Informacion se aktualisht, në 4 shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtrëtarë po marrin trajtim 555 persona. Në shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtrëtarë për vitin 2020 janë shtruar 1999 persona, për vitin 2021 janë shtruar 3185 persona, për vitin 2022 janë shtruar 3135 persona dhe për vitin 2023 janë shtruar 3056 persona. Plani e Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026 e gjëni në linkun: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Plani-i-Veprimit-per-Shendetin-Mendor-2023-2026.pdf . Në vend janë 4 shërbime të shëndetit mendor të specializuara me shtrëtarë (spitale dhe shërbime psikiatrike), dhe janë planifikuar/po zbatohen investime të rëndësishme në këto shërbime. Përkatesisht në Spitalin Psikiatrik Vlorë fondi total i investimit nga buxheti i shtetit për këtë investim është 208 milionë lekë, ku përfshihen dhe pajisje. Puna ka filluar dhe është parashikuar që godinat të vihen në funksion brenda vitit 2025. Ndërkohë, rikonstruksioni i Spitalit Psikiatrik, Elbasan është planifikuar me vlerë të përafërt 279 milion lekë nga buxheti i shtetit, ku përfshihen dhe pajisjet. Investimi do të çelë gjatë vitit 2024 dhe është parashikuar për t'u mbyllur brenda vitit 2026. Gjithashtu, është planifikuar edhe rikonstruksioni i Shërbimit të Psikiatrisë në QSUT, me vlerë 193 milion lekë (fonde kredi të Bankës Botërore) dhe është në proces prokurimi. Prirë të nisin punimet me afat 1 vjeçar për zbatimin e tyre.	E plotë
3	08.01.2024	08.01.2024	Informacion për përfitim nga programi i kredive me 0% interes për banesa.	Informacion se Referuar VKM Nr. 469, datë 26.7.2023 "Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike" pika 1: Kuota të përgjithshme të kredive të lehtësuara për administratën publike për vitin 2023 janë 300, të cilat ndahen, si më poshtë vijon: a) 100 për mjekët e sistemit shëndetësor publik; b) 100 për punonjësit e Policisë së Shtetit; c) 100 për ushtarët e Forcave të Armatosura.	E plotë
4	08.01.2024	19.01.2024	Informacion për azilet publike dhe private në Republikën e Shqipërisë.	Informacion se Në Republikën e Shqipërisë janë 6 (gjashtë) Institucione Rezidenciale Publike për të moshuar dhe 2 (dy) Qendra Polivalente Ditore Publike. Nga harta e shërbimeve shoqërore rezultoi se janë 21 institucione rezidenciale jopublike për të moshuar në Republikën e Shqipërisë. Numri i të moshuarve të sistemuara në institucionet Rezidenciale Publike për të moshuar është 319. Numri i të moshuarve të sistemuara në Qendrat Polivalente Ditore Publike është 82. Shërbimi Social Shtetëror nuk i disponon të dhënat mbi numrin e përfituesve në institucionet jopublike për të moshuar. Ato inspektohen nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ku mund të drejtoheni për informacionin e kërkuar. Shërbimi Social Shtetëror në zbatim të ligjit 121/2016 " për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" monitoron vetëm Institucionet Publike të financuara plotësisht apo pjesërisht nga buxheti i shtetit, për të moshuar. Problematikat e hasura gjatë monitorimeve janë : - Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve, kryesisht që janë në administrim të pushtetit vendor. - Rritja e numrit të moshuarve me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe aftësisë së kufizuar gjë që kërkon staf të shtuar dhe të mirëtrajtuar.	E plotë
5	12.01.2024	14.01.2024	Informacion për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror.	E deleguar
6	22.01.2024	22.01.2024	Informacion për tenderin e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për barnat Cyclophosphamide, Goserelin, Methotrexate dhe Cytosine.	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt "B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese të gjakut, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike ", ndarë në 128 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj", ku bëjnë pjesë barnat e kërkuara si më poshtë: -Lot6 Cyclophosphamide anhydrous, 500 mg, Flakon, -Lot18 Goserelin acetate, 10.8 mg, Shiringë e para përgatitur, -Lot21 Methotrexate, solution for injection and infusion x500 mg (10ml ose 20 ml), Flakon/ Ampule, -Lot22 Methotrexate, solution for injection shiringë e parapregatitur x 10mg/0.4ml, shiringë e parapregatitur x 10mg/0.4ml. -Lidhur me barnin Cytosine (Citozina) të kërkuar, sqarimë se ky bar nuk është prokuruar në mënyrë të përqëndruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sqarimë se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vepruar në cilësinë e Organit Qëndror Blerës për prokurimin e barnave, më pas janë spitalet ato të cilët procedojnë me lidhjen e minikontratave, duke qenë se kanë edhe fondet buxhetore.	E plotë
7	23.01.2024	23.01.2024	Informacion për importin e disa produkteve kozmetike.	Informacion se ju lutem t'i referoheni linkut https://shendetesia.gov.al/publikime-kozmetika në lidhje me kuadrin ligjor për produktet kozmetike. Referuar Ligjit Nr.26/2017 "Për Produktet Kozmetike", ju duhet të njoftoni Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me produktin që do të vendosni në treg. Për çdo produkt kozmetik, ju duhet të dorëzoni të dhënat që identifikojnë produktin si dhe raportin e sigurisë së produktit. Dokumentet e njoftimit janë të detajuara në nenin 11 dhe 12 të Ligjit Nr.26/2017 "Për Produktet Kozmetike". Personi përgjegjës i caktuar nga prodhuesi duhet të bëjë njoftimin, në adresën zyrtare: info.kozmetika@shendetesia.gov.al	E plotë
8	23.01.2024	02.02.2024	Informacion për akreditimin e institucioneve shëndetësore.	Informacion se në kuptim të Ligjit Nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, akreditimi është proces i certifikimit të cilësisë së institucionit shëndetësor nëpërmjet vlerësimit të jashtëm të cilësisë, në përputhje me standardet e cilësisë për akreditim, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Institucionet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen procesit të akreditimit, i cili kryhet nga institucioni përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor. Përjashtim nga ky rregull bëjnë laboratorët mjekësorë. Ky proces rregullohet me VKM nr. 865, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afatëve kohore. Në kuptim të ligjit, standardet e cilësisë për akreditim shëndetësor ndahen në standardet bazë të cilësisë, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga institucionet e kujdesit shëndetësor, dhe standardet opsionale, të cilat shërbejnë për akreditimin e institucionit. Procesi i akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor është një proces i cili vijon sipas përcaktimeve në ligjin Nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe VKM nr. 865, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afatëve kohore." Procesi i akreditimit është vijim i detyrimit për të pëmbushur standardet bazë të cilësisë për akreditim. Vetëm nëse një institucion i pëmbush standardet bazë, mund të vijojë procesin e akreditimit. Referuar VKM nr. 865, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afatëve kohore": 3. Pas licencimit të veprimtarisë përkatëse, të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen verifikimit nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetësisë të pëmbushjes së standardeve bazë për akreditim. 4. Grupet e inspektimit verifikojnë pranë institucioneve të kujdesit shëndetësor pëmbushjen e standardeve bazë të akreditimit, të miratuara nga ministri dhe hartojnë raportin përkatës me institucionin që kanë pëmbushur ose jo standardet bazë të akreditimit. Ky raport dërgohet pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe institucionit përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me VKM-në Nr. 210 datë 06.04.2022 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030" ka miratuar strategjinë për shëndetësinë për vitet 2021-2030 dhe po punon për plotësimin e objektivave të parashikuara.	E plotë

9	02.02.2024	19.02.2024	Informacion për autizmin në Shqipëri.	<p>Informacion se numri i personave me autizëm që përfillojnë pagesë të afësisë së kufizuar është 2.415. Sipas qarqeve numri i personave me autizëm ndahet në: 169 Qarku Berat, 19 Qarku Dibrë, 223 Qarku Durrës, 119 Qarku Elbasan, 114 Qarku Fier, 111 Qarku Gjirokastrë, 177 Qarku Korçë, 12 Qarku Kukës, 56 Qarku Lezhë, 58 Qarku Shkodër, 1,177 Qarku Tiranë dhe 180 Qarku Vlorë.</p> <p>Për sa i përket kujdesit shëndetësor, Çrregullimet e Spektrit të Autizmit trajtohen në nivel komunitar nga Kujdesi Shëndetësor Parësor dhe Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor (mjeku i familjes/i përgjithshëm, mjeku pediatër, infermier, staf psikosocial), si dhe në nivel kombëtar nga Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët (lokalizuar në Kombinat, Tiranë) dhe Shërbimi i Psikiatrisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.</p> <p>Në Kujdes Shëndetësor Parësor, Mjekët e Këshillimore së Nënës dhe Fëmijës ndjekin zhvillimin e fëmijëve sipas udhërrëfyesëve e protokolleve të përditësuara për monitorimin e zhvillimit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nëse fëmija paraqet probleme sipas instrumentave depistues pjesë e protokolleve, referohet në shërbimet e specializuara të shëndetit mendor, ku bëhet vlerësimi dhe vëhet diagnoza, si dhe hartohet plani individual i ndërhyrjes.</p> <p>10 Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor janë të lokalizuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 3 QKSHM Tiranë; - 1 QKSHM në Elbasan; - 1 QKSHM në Vlorë; - 1 QKSHM në Korçë; - 1 QKSHM në Shkodër; - 1 QKSHM në Berat; - 1 QKSHM në Kavajë; - 1 QKSHM Gramsh. <p>Në këto qendra ndiqen 2814 persona me çrregullime të Spektrit të Autizmit.</p> <p>Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, ofron shërbime të shëndetit mendor për fëmijët e grupmoshës 0- 18 vjeç. Këto shërbime ofrohen nga ekupe multidisciplinare të përbërë nga mjekët - psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë, pediatër dhe neuropediatër, si dhe infermiere; psikolog, punonjës social, logopedistë, fizioterapistë, terapistë okupacionalë, terapistë zhvillimi, edukatorë të specializuar dhe specialist promociioni. Shërbimet ofrohen në rrugë ambulatore si dhe me hospitalizime për fëmijët e moshës 0- 6 vjeç të shoqëruar nga prindër/kujdestari ligjor, për efekt rehabilitimi, i cili ofrohet për fëmijët e zonave të largëta. Numri i shtretërve në këtë qendër është 25, për fëmijë dhe nënat me frekuencim të javor.</p> <p>Shërbimi i Psikiatrisë pranë QSUT, në sistemin shëndetësor huan rolin e diagnostikuesit fundor sipas grupmoshave (halka e fundit e referimeve), ndërhyrjes në rastet e vështira të komorbiditeteve (diagnozat shumëfishë), veçanërisht në adoleshencë, hartuesit dhe konsultuesit për planet individuale të ndërhyrjes për zhvillimin e fëmijëve, për institucionet publike. Ky shërbim ka një kapacitet prej 90 shtretërish (shërbimi për fëmijë, adoleshentë dhe të rritur).</p> <p>Çrregullimet e Spektrit të Autizmit trajtohen nga mjekët psikiatër. Për grupmoshën e fëmijëve dhe adoleshentëve, ky shërbim i specializuar ofrohet nga mjekët psikiatër për fëmijët dhe adoleshentët. Aktualisht në sistemin shëndetësor publik ofrojnë shërbim për shëndet mendor 69 mjekë të specializuar në psikiatri.</p>	E plotë
10	07.02.2024	08.02.2024	Informacion për produktet kozmetike në Republikën e Shqipërisë.	<p>Informacion se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A është importuesi përgjegjës për përkthimin e etiketimit të produktit kozmetik në shqip? Cilat janë përgjegjësitë e një importuesi në Shqipëri? Ju lutem t'i referoheni Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike" Neni 6 dhe në lidhje me Etiketimin, ju lutem t'i referoheni Nenit 16 të tij. 2. A është e mundur të shoqërohet një njoftim i produktit me më shumë se një person? Me fjalë të tjera, nëse ka më shumë se një importues, a mund të përfillojë të dy nga i njëjti njoftim? Po, secili prej tyre duhet të plotësojë kërkesat e parashtuara në Ligjin Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike" Neni 12. Njoftimi bëhet në adresën info.kozmetika@shendetesia.gov.al. 3. A ka ndonjë kosto të lidhur me njoftimin (formularin) dhe vlerësimin e një produkti kozmetik nga Ministria e Shëndetësisë? Njoftimi bëhet në adresën info.kozmetika@shendetesia.gov.al. Njoftimi është pa pagesë. 4. Ministria e Shëndetësisë duhet të miratojë informacionin që përmban formulari i produktit dhe vetëm atëherë produkti mund të tregtohet? Nëse po, sa kohë i duhet Ministrisë së Shëndetësisë për të vlerësuar formularin? Pas njoftimit tuaj në adresën e sipërcituar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ju kthen përgjigje në lidhje me njoftimin tuaj. 5. Nëse produkti ka variacione (volum, aromë, ngjyrësje), a është e mundur të bëhet një njoftim i vetëm që merr parasysh të gjitha variacionet? Po, për secilin prej tyre. 6. A ekziston një sistem kozmetovigilance për të raportuar efektet e padëshirueshme të shaktuara nga produktet kozmetike? Ju lutem t'i referoheni Nenit 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike". 	E plotë
11	12.02.2024	27.02.2024	Informacion në lidhje me të pastrehët në Republikën e Shqipërisë.	<p>Informacion se në kuadër të politikave të mbrojtjes sociale, të pastrehët mund të përfillojnë shërbime në qendrat komunitare, të ngritura në nivel vendor, në zbatim të Ligjit 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Në nivel kombëtar funksionon Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave, institucion në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Qëllimi i kësaj qendre është t'ju vijë në ndihmë individëve dhe familjeve në emergjencë social-ekonomike, që vijnë nga grupe të ndryshme shoqërore. Aktualisht në këtë qendër trajtohen 37 familje. Kohëzgjatimi në qendër është më pak se 1 vit dhe familjet pas daljes, përfshihen në Programet e Strehimit Social që ofrohen nga Bashkëti.</p> <p>Shërbimet janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strehim në apartamentet e qendrës. • Shërbim shëndetësor. • Fuqizim i familjes nëpërmjet nxatjes së punësimit dhe përfitimit nga programet e strehimit të pushtetit vendor. • Shërbim për fëmijët (programe edukimi, arsimim, dhe aktivitetet) • Shërbime integruese përfshirë aktivitetet ndërgjegjësimi, aktivitetet psikosociale për familjen dhe anëtarët e saj. • Kurse Prindërimi. <p>Në kuadër të Ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar shtesat në nevojë pa të ardhura përfillojnë nga skema e ndihmës ekonomike, duke aplikuar pranë njësisë administrative ku janë të regjistruar.</p>	E plotë

12	27.02.2024	27.02.2024	Informacion në lidhje me Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.	E deleguar
13	12.03.2024	13.03.2024	Informacion në lidhje me procedurën IVF falas për komunitetet vulnerabel.	Informacion se për të përfutur shërbimin e kërkuar, duhet të drejtoheni tek mjeku i tyre i familjes. Mjekët e familjes disponojnë udhëzimin përkatës me kriteret kualifikuese për përfuturim e kësaj procedure. Pasi të kalohet kjo hapllë dhe plotësohen kriteret, ata referohen menjëherë pranë Qendrës së Teknikave të Riprodhimit të Asistuar në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinokologjik "Koço Gëlozheni" për të vijuar me konsultën dhe për të vlerësuar mundësitë dhe probabilitetin e rezultateve.	E plotë
14	12.03.2024	21.03.2024	Informacion në lidhje me PAK në raste abuzimi dhune apo te shkeljeve të drejtave të njeriut.	Informacion se Standardet e përkujdesit shoqëror për qendrat që ofrojnë shërbime ditore dhe rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara janë të miratuar me VKM Nr. 822, datë 6.12.2006 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore". Standardet e akreditimit të institucioneve nuk janë miratuar ende. Veprimtaritë "Shërbime të përkujdesit shoqëror" bëjnë pjesë në kategorinë X.1 të shtojcës së ligjit nr.10/081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar. Kategoritë e kësaj veprimtarie ndahen në dy nënkategoritë si vijon: a) "Shërbime të përkujdesit komunitar" me kodin X.1.A ku vendimmarrës është Qendra Kombëtare e Biznesit. b) "Shërbime të përkujdesit rezidenciale" me kodin X.1.B ku vendimmarrës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto veprimtaritë mund të specifikohen dhe/ose specializohen sipas natyrës së shërbimit dhe/ose grupeve e individëve përfutues. Institucionet e përkujdesit shoqëror, që ofrojnë shërbime për personat me AK, të financuara tërësisht apo pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe janë në varësi të plotë nga SHSSH apo dyfishë SHSSH-Bashkia, monitorohen nga Shërbimi Social Shtetëror. Të gjitha institucionet e tjera të përkujdesit për personat me AK inspektohen nga Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Gjithashtu këto institucione monitorohen edhe nga institucione të pavarura si Avokati i Popullit apo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për çështje të veçanta. Mekanizmat lehtësues për të raportuar çdo rast dhunë janë: li Shërbimi Social Shtetëror li Avokati i Popullit li Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi li Policia li Linjat e këshillimit për rastet e dhunës li Koordinatori vendor për barazim gjinor Bazuar në standardet e përkujdesit shoqëror për ofrimin e shërbimit për personat me AK, në çdo institucion që ofrohet shërbime sociale është e vendosur një kuti ankimi. Kjo kuti hapet çdo muaj nga një komision i cili ka përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, një përfutues, përfaqësues nga bashkia. Gjithashtu procedurat e ndjekura nëse ka raste denoncimi për abuzim monitorohet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, apo Avokati i Popullit. Organet kompetente që trajtojnë raste të viktimave të dhunës bashkëpunojnë me të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror të cilat ofrojnë shërbime, për personat me AK në nivel vendor apo në nivel kombëtar me qëllim që çdo person me AK të marrë shërbimet e nevojshme.	E plotë
15	13.03.2024	29.03.2024	Informacion në lidhje me mjekimin e detyruar në Republikën e Shqipërisë.	Informacion se sipas nenit 46 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, mjekimi i detyruar hyn në masat mjekësore që mund të jepen nga gjykata ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor që shpallen të papërgjegjshëm për kryerjen e veprës penale. Masat mjekësore janë mjekimi i detyruar ambulator ose mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor. Për sa më sipër, informojmë se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk disponon statistika të plota për rastet me masë mjekësore mjekimi i detyruar si dhe të dhëna të tjera të parashtruara në kërkesën tuaj.	E plotë

16	13.03.2024	02.04.2024	Informacion në lidhje me transplantin e veshkave në Republikën e Shqipërisë.	<p>Informacion se transplantat renal është realizuar tek të gjithë pacientët, të cilët kanë plotësuar kriteret klinike dhe ligjore. Një ndër paketat më kryesore të financuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është edhe Paketa e Transplantit Renal, e cila ka filluar të financohet 100 % nga FSDKSH në vitin 2015.</p> <p>Çmimi i transplantit është i përcaktuar në VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 "Për Miratimin e Paketave të Shërbimeve Shëndetësore që do të Financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor", të ndryshuar.</p>	E plotë
17	15.03.2024	09.04.2024	Informacion në lidhje me infektimin me tuberkuloz në Republikën e Shqipërisë.	<p>Informacion se Republika e Shqipërisë ndan angazhimin ndërkombëtar për forcimin e sistemeve shëndetësore drejt ofrimit të shërbimeve shëndetësore të integruara, me qytetarin në qendër dhe i jep përparësi kujdesit shëndetësor parësor. Në këtë mënyrë, më 01 Nëntor 2019, në tre institucione shëndetësore (Kamëz, Lushnjë dhe Tiranë [Qendra Shëndetësore nr. 4]), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vendosi të përkrahë decentralizimin e kujdesit dhe parandalimit të tuberkulozit (TB) në kujdesin shëndetësor parësor, përpara zbatimit në mbarë vendin. Projekti pilot i TB/PHC në pas u zgjerua në tetor-dhjetor 2022 në katër institucione të tjera shëndetësore (Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Kukës). Angazhimi i fortë politik për eliminimin e TB në Shqipëri, së bashku me shërbimet shëndetësore në kujdesin shëndetësor parësor, si dhe koordinimi i tyre në këto nivele, konsiderohen si gurë themeli strategjik drejt zbulimit të hershëm të tuberkulozit (TB) dhe përmirësimit të trajtimit dhe parandalimit. Republika e Shqipërisë sot, ka ulur ndjeshëm numrin e rasteve të reja (incidence), në nivelet 10.24/100.000 banorë duke qenë pranë objektivave 2030. Republika e Shqipërisë ka arritur uljen e dëgjendimit në spitale për rastet TB dhe përmirësuar ndjeshëm suksesin në trajtim deri në masën 92%. Medikamentet janë të cilësisë më të lartë të mundshme. Për të trajtuar format rezistente ndaj medikamenteve, janë siguruar alternativat dhe gjeneratat e avancuara të tyre.</p>	E plotë
18	25.03.2024	09.04.2024	Informacion në lidhje ndërtimin e një fabrike vaksinash në Republikën e Shqipërisë.	<p>Informacion se në periudhën e fillimit të pandemisë, shtetet u përballën me një numër të madh rastesh me Covid-19 dhe impaktin që kjo sëmundje pati në sëmundshmërinë dhe mortalitetin e pacientëve, sidomos ata me imunitet të kompromentuar. Vaksinat ishin mundësia e vetme për të imunizuar popullatën, por fillimisht mjaft e vështirë për t'u siguruar. Përpjekjet e qeverisë shqiptare, personalisht të Z. Kryeministër dhe MSHMS ishin të shumta dhe të orientuara në disa plane.</p> <p>Për shkak të mosreagimit në kohë të Bashkimit Europian, për të mbështetur me doza vakcine kundër SARS COV 2 vendet e rajonit, çdo qeveri në mënyrën më të arsyeshme kishte përgjegjësinë e zgjidhjes së rrugëve apo mundësive alternative, për të siguruar mbrojtjen e shëndetit publik, në sigurimin e vaksinave antiCOVID, përshirë këtu edhe mundësinë për një fabrikë vaksinash të teknologjisë së lartë.</p> <p>Thëksojmë se, në atë periudhë vaksinat në gjendje nuk mbulonin nevojat për vaksinim, ku deri në pranverën e vitit 2022 duhet të kishim siguruar doza vakcine (dozë e parë) për të gjithë popullatën, si dhe mundësinë për dy apo më shumë doza, duke gëzuar sipas projeksioneve epidemiologjike ku vaksinimi mund të kthehej si vakcina e gripit sezonal.</p> <p>Mospasja e një fleksibiliteti në prokurimin e drejtpërdrejtë të vaksinave antiCOVID apo mospasja e sigurtimit të vaksinave në shtetë të plotë që të mbulonin gjithë popullatën rezidente, bëri të mundur hyrjen në tratativa direkte të sigurimit të vaksinave Pfizer me marrëveshje të drejtpërdrejtë të Qeverisë shqiptare me kompaninë, gjë që siguron edhe qëndrueshmërinë në këtë proces.</p>	E plotë
19	02.04.2024	03.04.2024	Informacion në lidhje me legalizimin e dokumentacionit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.	<p>Informacion se dokumentat për vulojë mund të sillen dorazi ose dërgohen me postë, por normalisht që duke i sjellë dorazi përfundon më shpejt si procedurë, pasi eviton kohën që i nevojitet postës për t'i sjellë. Për çdo informacion më të detajshëm lutemi t'i drejtoheni recepsionit tonë.</p>	E plotë

20	04.04.2024	04.04.2024	Informacion në lidhje me shërbimin e ofruar nga ana e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.	E deleguar
21	10.04.2024	11.04.2024	Informacion në lidhje me ushtrimin e profesionit mjek në Republikën e Shqipërisë.	Informacion se njohja e diplomave është kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ky shërbim ofrohet në portalin e-Albania. Leja e Ushtrimit të Profesionit jepet nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë. Procedurat për punësimin e mjekëve në institucionet shëndetësore publike, bëhet nëpërmjet portalit "Mjekë për Shqipërinë". Ju lutem konsultoni linkun: https://mjeke.shendetesia.gov.al/	E plotë
22	15.04.2024	09.05.2024	Informacion në lidhje me fertilizimin in vitro në Republikën e Shqipërisë.	Informacion se fertilizimi in vitro, një shërbim risi në shërbimin publik, si një politikë shëndetësore për çiftet me vështirësi të riprodhimit u ngrit në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gëlozheni" pas një investimi në infrastrukturë, pajisje dhe kapacitete të riorganizuara njerëzore. Në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gëlozheni" është ngritur qendra e parë kombëtare publike e teknikave të riprodhimit të asistuar. Në muajin Shkurt 2024, është kryer procedura e parë e teknikave të riprodhimit të asistuar dhe janë realizuar 10 (dhjetë) procedura. Procedurat e teknikave të riprodhimit të asistuar ku, futet edhe fertilizimi in vitro, ofrohet falas për të gjithë qytetarët të cilët referohen nga mjeku i familjes në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.	E plotë
23	29.04.2024	07.05.2024	Informacion në lidhje me numrin e nënave me 3 fëmijë që kanë përfutuar nga mbështetja sociale e Qeverisë.	Informacion se në zbatim të Vendimit Nr. 751, datë 1.12.2022 "Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç", që nga muaji Janar 2023 deri në muajin Mars 2024 janë përfutuese nga sistemi 8,911 gra të papuna. Grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfatimi pensioni pleqërie dhe barrëlidhjeje. Të dhënat e përfutueseve gra janë të disagreguara në nivel qarku, si më poshtë vijon: Berat 287, Dibër 812, Durrës 872, Elbasan 999, Fier 692, Gjirokastrë 134, Korçë 642, Kukës 678, Lezhë 685, Shkodër 933, Tiranë 1,897, Vlorë 280.	E plotë

24	03.05.2024	20.05.2024	Informacion në lidhje me lidhur me komitetin Rom.	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale monitoron dhe zbaton Planin Kombëtar të Veprimit, Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje, të romëve dhe egjiptianëve, 2021-2025 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 701, datë 18.11.2021. Në Planin Kombëtar përcaktohen prioritetet strategjike dhe politika në fushat e aksesit në drejtësi, arsimit dhe kulturës, punësimit, strehimit, mbrojtjes sociale, dhe antixhpsizmit duke respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, në përputhje me standartet ndërkombëtare.</p> <p>Ky plan përcakton një objektiv për punësimin, i cili rrjedh nga Strategjia Sektoriale për Punësimin dhe Afësitë 2030, për zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës.</p> <p>Përsa i përket pakicës Romë dhe Egjiptiane, të njohura si pakica në Ligjin Nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", sipas Nenit 8 është përcaktuar ndalimi i diskriminimit ndaj çiklo personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakicë kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës.</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimin për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe sigurimi i mbrojtjes nga diskriminimi është i rëndësishëm për komunitetet romë dhe egjiptiane, për të luftuar stigma dhe diskriminimin dhe për të fuqizuar komunitetet. Për këtë, është zhvilluar dialog i vazhdueshëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me grupin ndërmnistror dhe shoqërië civile si dhe trajnime për mosdiskriminim dhe antixhpsizmin nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion koordinues për realizimin e të drejtave të Romëve dhe Egjiptiane, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në shoqëri, ka bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Punësimin dhe Afësitë, përsa i përket zbatimit të legjis lacionit në fuqi për punën dhe statistikave të punësimit.</p> <p>Në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, të dhënat janë përsa u përket programeve të nxitjes së komunitetit romë dhe egjiptianë të papunë dhe punëkërkuës të cilët paraqiten në Zyrat e Punës dhe trajtohen me shërbime punësimi, programe të nxitjes së punësimit ose kurse formimi profesional.</p> <p>Përsa më sipër, ju lutem të drejtoheni pranë institucioneve përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional.</p>	E plotë
25	07.05.2024	09.05.2024	Informacion në lidhje me raportin e monitorimit vjetor për vitin 2023.	<p>Informacion se raporti i monitorimit për vitin 2023 është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në linkun: https://shendetesia.gov.al/https://shendetesia.gov.al/labelat-e-raportimit-per-intervale-kohore-3-muj-9-muj-dhe-vjetore-si-dhe-rehacionet-perkatese/</p>	E plotë
26	14.05.2024	16.05.2024	Informacion në lidhje me investimet në shëndetësi.	<p>Informacioni që kërkoni gjendet i botuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</p> <p>Ju lutem t'i referoheni linkut: https://shendetesia.gov.al/https://shendetesia.gov.al/labelat-e-raportimit-per-intervale-kohore-3-muj-9-muj-dhe-vjetore-si-dhe-rehacionet-perkatese/</p>	E plotë
27	23.05.2024	24.05.2024	Informacion në lidhje me importimin e pajisjeve mjekësore në Republikën e Shqipërisë.	<p>Informacioni se me qëllim kryerjen e aktivitetit tuaj, duhet të pajiseni me Autorizim për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Aplikimin duhet ta kryeni në linkun https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?Service_code=14027 ku janë të sqarura të gjithë hapat e procedurës.</p> <p>Për të ushtruar këtë aktivitet, duhet të jeni person juridik.</p>	E plotë

28	23.05.2024	29.05.2024	Informacion në lidhje me faqen zyrtare dhe programin e transparencës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale	<p>Informacioni se Institucioni kompetent për menaxhimin e faqes zyrtare të ministritë është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.</p> <p>Referuar Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" të ndryshuar, programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.</p> <p>Si pasojë e ndryshimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale përditëson në mënyrë të vazhdueshme kategoritë që gjenden në Programin e Transparencës.</p> <p>Nuk ka patur kërkesa nga subjekte në lidhje me aksesueshmërinë në Programin e Transparencës, por zakonisht kërkesat për informacion i drejtohen autoritetit publik megjithëse informacioni gjendet i publikuar.</p>	E plotë
29	30.05.2024	07.06.2024	Informacion se çfarë mbështetje ofrohet nëpërmjet politikave të qeverisë, me qëllim që të sigurohet gëzimi në baza të barabarta me të tjerët i të drejtës për arsim, nga ana e nxënësve që i përkasin pakicës kombëtare romë dhe pakicës kombëtare egjiptiane dhe cilat janë politikat dhe strategjitë që ka ndërmarrë qeveria në zbatim të këtyre masave, brenda kompetencës së ministritë që ju drejtoni.	<p>Informacioni se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale ndjek dhe monitoron "Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025" (miratuar me Vendimin nr. 701, datë 18.11.2021), të cilin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare.</p> <p>Objektivat dhe masat e Planit lidhen me të gjitha fushat e përfshirjes, barazisë dhe pjesëmarrjes në shoqëri. Plani bazohet në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave kombëtare.</p> <p>Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale bashkëpunon me ministritë e linjës, në veçanti me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si ministria që mbulon çështjet e arsimit gjithëpërfshirës. Për këtë, janë zhvilluar takime në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet vendore në Bashkinë Korçë.</p> <p>Masat konkrete të përfshirjes sociale në arsim dhe segregimin në Planin e Veprimit, janë parashikuar dhe zbatohen nga Ministria e Veprimit dhe Sportit, në një plan masash, për trajtimin e segregimit në shkolla dhe përfshirjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim, bazuar në parimin e mosdiskriminimit.</p> <p>Përsa i përket masave të marra për mbrojtjen sociale dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor, këto janë parashikuar në kuadrin strategjik dhe legjislativ, përkatësisht për mbrojtjen sociale dhe shëndetësinë, sipas fushës së mbulimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale.</p> <p>Në mbrojtjen sociale janë ofruar pagesa për familjet në ndihmë ekonomike dhe shërbime sociale të ofruara në nivel kombëtar, nga të cilat komuniteti rom dhe egjiptian janë përfitues në njësitë vendore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale, nëpërmjet Fondit Social ka dhënë mbështetje financiare për bashkitë, qendrat emergjente dhe qendrat komunitare multifunkionale.</p> <p>Politika sociale si bonusi i bebes dhe ajo e mbështetjes me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për nënat me mbi 3 fëmijë, kanë sjellë rezultate pozitive. Në 100 qendra socio-shëndetësore, tashmë ofrohen dhe shërbime të integruara për qytetarët, me fokus në grupet e marginalizuara.</p> <p>Po ashtu, një bashkëpunim midis institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen sociale dhe punësimin në bashkëpunim me shoqërinë civile, është ngritur një mekanizëm referimi, i cili mbështet punësimin dhe integrimin social të përfituesve të ndihmës ekonomike në moshë pune me grupe rajonale të punës, me përfaqësim nga zyrat e punësimit, shërbimi social shtetëror dhe bashkitë.</p> <p>Sipas Planit Kombëtar, po vijon puna për reduktimin e hendekut në cilësinë e shëndetit midis romëve dhe egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë, me ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor dhe të përballueshëm për romët dhe egjiptianët, me qëllim mbulimin Universal Shëndetësor për Romët dhe Egjiptianët si pjesë e të gjithë popullsisë.</p> <p>Rritja e aksesit në shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë fëmijët dhe prindërit e grupeve vulnerabel dhe të marginalizuara dhe veçanërisht për gratë shtatzëna, nënat dhe foshnjat shoqërohet me ndërgjegjësim në komunitet. Romët dhe egjiptianët kanë marrë informacion për çështjet e shëndetit fizik, mendor dhe riprodhues, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, imunizimin e fëmijëve 0-14 vjeç etj, si dhe kanë përfituar shërbime nga ekipet mjekësore të levizshme.</p> <p>Fëmijët e moshës 0-18 vjeç përfitojnë të gjitha shërbimet parandaluese ose të kujdesit shëndetësor sipas Paketës Bazë të Kujdesit Parësor Shëndetësor, pavarësisht nga vendbanimi ose statusi i tyre social dhe ekonomik, përfshirë dhe vaksinimin. Gjithashtu, në zonat rurale dhe urbane po përmirësohet ndjeshëm aksesit i romëve dhe egjiptianëve duke ofruar shërbime pranë vendbanimit.</p>	E plotë
30	25.06.2024	05.07.2024	Informacion se në çfarë faze është projektligji "Për shëndetin seksual dhe riprodhues".	<p>Informacioni se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojjes Sociale ka zhvilluar procesin konsultativ ku janë organizuar tryeza dhe takime me grupet e interesit. Janë duke u vlerësuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e bëra gjatë këtyre takimeve si dhe ato të përcjella me postë elektronike.</p> <p>Ligji do të ripunohet duke marrë në konsideratë ato komente dhe sugjerime, të cilat ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së ligjit dhe më pas ligji do të vijojë me procedurat e diskutimeve me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe vetëm pas miratimit me VKM të draftit, do të paraqitet për diskutime në komisioin parlamentare. Kjo është një procedurë ligjore që ndjek procesin miratimit të një ligji.</p>	E plotë

31	06.07.2024	08.07.2024	Informacion në lidhje me barnat e rimbursueshme.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar
32	16.07.2024	17.07.2024	Informacion në lidhje me repartin e gastrohepatologjisë.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.	E deleguar
33	17.07.2024	17.07.2024	Informacion në lidhje me tekstet shkollore falas.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.	E deleguar
34	23.07.2024	23.07.2024	Informacion në lidhje me spitalin Onkologjik në QSUT.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.	E deleguar

35	29.07.2024	05.08.2024	Informacion në lidhje me publikimin e listës së barnave të rimbursueshme.	Informacion se Lista e Barnave të Rimbursueshme gjendet e publikuar në linkun: https://fshksh.gov.al/project/lista-e-barnave/	E plotë
36	07.08.2024	08.08.2024	Informacion në lidhje me Strategjinë e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025.	Informacion se Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025 gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka pjesë integrale të saj edhe Planin e Veprimit të kostuar. Ju lutem t'i referoheni linkut: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Zhvillimit-t%C3%AB-Kujdesi-Paresor-2020-2025.pdf	E plotë
37	09.08.2024	12.08.2024	Informacion në lidhje me Ligjin 26/2017 "Për Produktet Kozmetike.	Informacion se Për produktet kozmetike ju lutem t'i referoheni kërkesave të Ligjit 26/2017 "Për Produktet Kozmetike", në lidhje me kërkesat për këto produkte si dhe detyrimin për njoftimin e tyre para vendosjes në treg.	E plotë
38	21.08.2024	23.08.2024	Informacion në lidhje me produktet biocide.	Informacion se Në kreun III të VKM nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg", përcaktohen kriteret dhe dokumentet të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit për autorizim. Gjithashtu në shojcën V, të kësaj vkm-je gjendet lista e lëndëve vepruese të miratuara për dhënie autorizimi.	E plotë

39	21.08.2024	23.08.2024	Informacion në lidhje me produktet biocide.	Informacion se Në kreun III të VKM nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg"; përcaktohen kriteret dhe dokumentet të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit për autorizim. Gjithashtu në shtojcën V, të kësaj vkm-je gjendet lista e lëndëve vepruese të miratuara për dhënie autorizimi.	E plotë
40	29.08.2024	02.09.2024	Informacion në lidhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore.	Informacion se legjislacioni për pajisjet mjekësore është: Ligji Nr.89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore", të ndryshuar Vendim nr. 731, datë 2.9.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit, Klasifikimin dhe Markimin CE të Pajisjeve Mjekësore Vendim Nr. 189, datë 9.3.2016 për miratimin e rregullit teknik "Për Kërkesat Thelbësore, Markimin CE dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Mjekësore Diagnostikuese in Vitro Vendim nr. 508, datë 10.6.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit dhe Markimin CE të Pajisjeve Mjekësore të Implantueshme Aktive Urdhër nr. 734 datë 18.10.2019 Per disa ndryshime ne urdhrin nr. 360 datë 22.08.2016 "Mbi Procedurat dhe Rregullat e Regjistrimit e Pajisjeve Mjekesore Ndryshimet dhe Anulimin e Regjistrimit te Tyre, Dokumentacionin e Nevojshem dhe Kostot Perkatase" ku mund ti gjeni dhe te publikuar ne linkun: https://akbpm.gov.al/legjislacioni/	E plotë
41	06.09.2024	06.09.2024	Informacion në lidhje me projekt-ligjin "Për shëndetin seksual dhe riprodhues"	Informacion se Projektligji "Për shëndetin seksual dhe riprodhues" gjendet i publikuar në linkun: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/727	E plotë
42	18.09.2024	24.09.2024	Informacion në lidhje me bonusin e bebeve.	Informacion se Programi Universal i Bonusit të Bebes mbështet financiarisht prindërit për lindjen e fëmijës së parë në vlerën 40.000 lekë, për fëmijën e dytë 80,000 lekë, dhe për fëmijën e tretë 120,000 lekë. Kjo është një politikë proaktive për të nxitur lindshmërinë dhe mbështetur familjet e reja, por jo vetëm. Në zbatim të nenit 9, të Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar është miratuar edhe Vendimi nr. 288, datë 10.04.2020 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës dhe procedurës së dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyrën e bashkëpunimit nëpërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile", i ndryshuar. Bazuar në aktet e mësipërme, institucionet e shërbimit spitalor publik dhe Shërbimi Social Shtetëror lëshojnë, pas regjistrimit në regjistrin e gjendjes civile, bonusin e bebeve për fëmijët e porsalindur. Shërbimi Social Shtetëror lëshon bonusin për fëmijët e lindur në institucionet e shërbimit spitalor jo publik.	E plotë

43	27.09.2024	01.10.2024	Informacion në lidhje me kujdestarinë për prindërit.	<p>Informacion se personi i interesuar mund të përfitojë pagesë për asistencë që mund t'i bëjë prindërve, nëse prindërit kanë kaluar në Komisionin e Vlerësimit të Afetësish së Kufizuar dhe po ky komision, në bazë të diagnozës, ka përcaktuar nevojën e ndihmës personale.</p> <p>Kjo bazuar në Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale", ku në kuadër të skemës së pagesës së personave me aftësi të kufizuar, një ndihmë personale (kujdestar), që mund të jetë një familjar, caktohet për të ndihmuar personin me aftësi të kufizuar, të përcaktuar me vendim të komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar (KMCAP / KMPV).</p>	E plotë
44	22.10.2024	28.10.2024	Informacion në lidhje me klinikat mjekësore.	<p>Informacion se subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtaritë Kabinet Mjekësor me Kodin A2 dhe Qendër Mjekësore me Kodin A4 licensohen bazuar në ligjin Nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për Licensat dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 "Për Licensat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta, i ndryshuar.</p> <p>Gjithashtu bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009 "Për Licensat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, citohet "Kabineti mjekësor" kryen vetëm një specialitet mjekësor të tilla si kabinet imazherie, kabinet optik me opticien, kabinet i diagnozës endoskopike dhe specialitete të tjera , me kodin A2 dhe "Qendra mjekësore" kryen disa specialitete mjekësore si vizita dhe konsulta mjekësore, diagnostifikim, trajtime ambulatorie, trajtime mikrokirurgjikale, me kodin A4.</p> <p>Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009, "Për Licensat dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" veprimtaritë e nënkategorisë II.6.A.1 "Kabinet Mjekësor" dhe "Qendër Mjekësore" janë licensa të grupit të dytë, për të cilat shqyrtues dhe vendimmarrës është vetëm Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe për rrjedhojë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk merr pjesë në procesin e licensimit për ushtrimin e veprimtarive të sipërcituara.</p> <p>Kriteret e licensimit për "Kabinetet mjekësore" dhe "Qendrat mjekësore" janë të publikuara në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu ju informojmë se në lidhje me mjekësinë estetike, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nisur procesin e hartimit të një kuadri rregullator në përputhje me standardet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.</p> <p>Për sa më sipër, legjislacioni për produktet kozmetike në Republikën e Shqipërisë parashikon vetëm përdorimin e produkteve në pjesën e jashtme të trupit të njeriut.</p>	E plotë
45	22.10.2024	01.11.2024	Informacion në lidhje me Fondin Social.	<p>Informacion se për vitin 2023 janë financuar 34 shërbime, nga këto 22 shërbime që ka vijuar financimi nga vitet e mëparshme në bashkitë: Durrës, Lezhë, Librazhd, Prenjas, Rroskovec, Berat, Korçë, Rrogozhinë, Kukës, Elbasan, Vlorë, Belsh, Kolonjë, Tepelenë, Devoll, Delvinë, Shkodër, Malësi e Madhe, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastrë, Patos dhe 12 shërbime të reja në bashkitë: Polican, Selencë, Gramsh, Bukujë, Klos, Malq, Kamëz, Cërrik, Pukë, Pogradec, Lezhë, Fier.</p> <p>Për vitin 2024 janë financuar 49 shërbime nga këto 34 shërbime që ka vijuar financimi nga vitet e mëparshme në bashkitë: Durrës, Lezhë, Librazhd, Prenjas, Rroskovec, Berat, Korçë, Rrogozhinë, Kukës, Elbasan, Vlorë, Belsh, Kolonjë, Tepelenë, Devoll, Delvinë, Shkodër, Malësi e Madhe, Sarandë, Lushnjë (2 shërbime), Gjirokastrë, Polican, Selencë, Gramsh, Bukujë, Klos, Malq, Kamëz, Cërrik, Pukë, Pogradec, Lezhë, Fier) dhe 15 shërbime të reja në bashkitë: Dimal, Mat, Vau Dejës, Memaliaj, Dropull, Fushë Arrëz, Dibër, Libohovë, Has, Kurbin, Këkëyrë, Patos, Gjirokastrë, Lushnjë, Tiranë.</p>	E plotë
46	28.10.2024	04.11.2024	Informacion në lidhje me Qendrën Kombëtare Tranzitore e Emergjencave.	<p>Informacion se kriteret për pranimin e familjeve në QKTE janë përcaktuar në VKM Nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".</p> <p>Shërbimi për të pastrehët, sipas përcaktimit të pikës 9, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kriterë: a) Të jenë mbi 18 vjeç e të pastrehë; b) Të jenë përfitues të ndihmës ekonomike ose në proces aplikimi për ndihmën ekonomike.</p> <p>Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon: a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes; b) Fotografinë e individit (2 copë); c) Raportin nga komisioni mjekë ligjor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit; ç) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile; d) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; dh) Verifikimi i aplikimit për ndihmë ekonomike ose për përfitimin e ndihmës ekonomike; e) Informacion mbi pasuritë e pajtuashme nga regjistri i ZRPP-së.</p> <p>Familjet që referohen për akomodim pranë qendrës janë familje të cilat gjenden vështirësi të theksuara socio-ekonomike.</p> <p>Njësi përkatese, Punonjësi Social në drejtoritë sociale të Bashkisë merr informacionin e nevojshëm për familjen/Individ, kryen vlerësimin për situatën emergjente në të cilën ndodhet familja më pas referohet për shqyrtim pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë.</p> <p>SHSSH shqyrtan kërkesën dhe vendos për pranimin ose jo, në varësi të vlerësimit për sistemin në QKTE me shkresën përkatese.</p>	E plotë

47	29.10.2024	04.11.2024	Informacion për barin SOMATOTROPINA.	Informacion se në ambientet e Farmacisë së Rimbursimit në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", është në dispozicion Somatotropina 5mg/10mg me emrin tregtar Genotropin të Kompanisë Pfizer, si dhe Somatotropina 8 mg të kompanisë Merck, gjithashtu Somatotropina është pjesë e Listës së Barnave të Rimbursueshme Spitalore.	E plotë
48	05.11.2024	05.11.2024	Informacion në lidhje me Spitalin Rajonal Memorial Fier.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Spitalit Rajonal Memorial Fier.	E deleguar
49	07.11.2024	07.11.2024	Informacion në lidhje me Spitalin Bashkiak Mat.	Përcjellje për kompetencë dhe trajtim Spitalit Bashkiak Mat.	E deleguar
50	12.11.2024	12.11.2024	Informacion në lidhje me punësimin e teknikëve të shkencave mjekësore.	Informacion se punësimi i personelit infermierë dhe i teknikëve të tjerë të shkencave mjekësore bëhet nëpërmjet Portalit "Infermierë për Shqipërinë". Regjistrimi i kandidatëve bëhet vetëm nëpërmjet këtij portali. Aplikimi bëhet për çdo Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (ku përfshihen dhe spitalet përkatëse).	E plotë

51	13.11.2024	14.11.2024	Informacion në lidhje me akreditimin e edukimit në vazhdim.	Informacion se mund t'i referoheni Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 28.10.2020 "Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre", për akreditimin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilin e gjeni të publikuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare.	E plotë
52	26.11.2024	27.11.2024	Informacion në lidhje me licencën e ushtrimit të profesionit infermier.	Informacion se mund t'i referoheni linkut https://urdhriinfermierit.org/aplikim-per-licensim-riicensim-dhe-vertetime/ në lidhje me rinovimin e licencës.	E plotë